

APLIKIM PËR LEJE PËR ZHVILLIMIN E RRJETEVE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE TË SHPEJTËSISË SË LARTË DHE SIGURIMIN E SË DREJTËS SË KALIMIT

Në zbatim të ligjit Nr. 120/2016 “PËR ZHVILLIMIN E RRJETEVE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE TË SHPEJTËSISË SË LARTË DHE SIGURIMIN E SË DREJTËS SË KALIMIT”, për miratimin e lejeve të Infrastruktues;

- Duhet të merret miratimi i Këshillit Bashkiak për kalimin e linjave të rrjetit kabllor në pronat publike të Bashkisë Vorë.
- Në rast se për interes publik apo nevoja dhe interesa të bashkisë do të dalë e nevojshme heqje, zhvendosje apo devijim i shtyllave dhe linjave, subjektet janë të detyruara të kryejnë këto punime me shpenzimet e veta dhe brenda afatit kohor që do ti përcaktohet nga bashkia sipas rastit. Për këtë do të njoftohen paraprakisht në përputhje me afatet e përcaktuara ligjore.
- Me marrëveshje ndërmjet operatorëve të ndryshëm dhe miratimin e Bashkisë mbështetur edhe në legjislacionin përkatës në fuqi, Infrastruktura mund të shfrytëzohet edhe nga operatorët e tjerë.
- Për gjatë gjithë kohës së operimit subjektet të cilat do të operojnë për vendosjen e linjave të rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë duhet që të shlyejë detyrimet për tarifat për Rrjetet Kabllore telefonike, ndërlidhëse apo të shërbimit informativ në përputhje me përcaktimet e Paketës Fiskale të Bashkisë Vorë.

Dokumentacioni I nevojshëm për pajisje me Leje Infrastruktore është si më poshtë vijon;

- Kërkesa për leje infrastruktore, sipas formatit të aplikimit, të përcaktuar në sistemin elektronik të lejeve;
- Dokumente që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në zhvillim, përfshirë marrëveshjet me pronarët e pronave private si dhe Vendimi i Këshillit Bashkiak për përdorim të pronave publike.
- Plani i vendosjes së rrjetit
- Plani i rilevimit
- Plani i Sistemit
- Plani Piketimit
- Plani Organizimit të punimeve
- Grafiku paraprak i punimeve dhe afati i dorëzimit të objekteve, sipas fazave të zbatimit;
- Preventivi i punimeve;
- Projekti Teknik i punimeve shoqëruar me detajet e vendosjes së linjave.
- Deklaratat e projektuesve të licensuar, Licensat Policë Sigurimi dhe QKR përkatëse.